



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 12 janar 2015
Nr. ref.: RK748/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI111/14

Parashtruesit

Mladen Denić dhe Milorad Vitković-Denić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të
Privatizimit, AC-I.-13-0041, të 5 qershorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Mladen Denić dhe z. Milorad Vitković-Denić, me vendbanim në Kraljevë, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës). Ata përfaqësohen nga z. Branislav M. Vitković, me vendbanim në Kraljevë, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I.-13-0041 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), i 5 qershorit 2014, për të cilin parashtruesit e kërkesës deklarojnë se e kanë pranuar më 16 qershor 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, kundër Aktvendimit (SCC-11-0026, të 20 marsit 2013) të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së), në lidhje me rikthimin e pronës së paluajtshme.
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksi i Gjykatave], paragrafi 7.
5. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të caktojë Masë të përkohshme, përkatësisht të ndalojë çdo shitje, rishitje, dhënie me qira apo nënqira, ndërtim apo vendosje të çfarëdo ngarkese mbi pronën e paluajtshme, e cila është objekt i kontestit.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 1 korrik 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 5 gusht 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan një dokument shtesë ku kërkuan që Gjykata të caktojë Masë të përkohshme.
9. Më 6 gusht 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI111/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. KI111/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

10. Më 8 gusht 2014, Gjykata informoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që Mladen Denić ta dorëzojë autorizimin për Branislav M. Vitković, në rast se zgjedh të përfaqësohet nga ai, siç ishte njoftuar në kërkesë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
11. Më 20 gusht 2014, Mladen Denić dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.
12. Më 12 shtator 2014, Gjykata informoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të komentojë lidhur me pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës përkitazi me tejzgjatjen e procedurës.
13. Më 23 shtator 2014, DHPGJS dorëzoi komentet në Gjykatë.
14. Më 8 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

I. Procedura në Gjykatën Kushtetuese

15. Përveç kërkesës në fjalë, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar edhe dy kërkesa të tjera në Gjykatë. Kërkesa e parë (KI18/10) ishte dorëzuar më 24 shkurt 2010 dhe kërkesa e dytë (KI130/11) ishte dorëzuar më 3 tetor 2011.
16. Më 12 prill 2011, Gjykata vendosi për rastin nr. KI18/10, duke e refuzuar kërkesën e parashtruesve për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit (Gzz. Nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007) të Gjykatës Supreme të Kosovës, si të papranueshme, për shkak se ata nuk i kishin shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.
17. Pas marrjes së aktvendimit të sipërpërmendur për papranueshmëri, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë kërkesën e tyre të dytë, ku kërkuan një rishqyrtim të atij aktvendimi të Gjykatës.
18. Më 4 maj 2012, Gjykata nxori aktvendimin e saj për rastin nr. KI130/11 dhe e refuzoi kërkesën e parashtruesve për rishqyrtim të aktvendimit të saj për papranueshmëri, në pajtim me rregullin 36 (3) e të Rregullores së punës, për shkak se ajo nuk konsideronte se ka bazë të mjaftueshme për një vendim të ri. Megjithatë, në lidhje me ankesën e parashtruesve përkitazi me tejzgjatjen e procedurës, Gjykata deklaroi se ky aktvendim *“nuk i ndalon parashtruesit e kërkesës të paraqesin kërkesë të re për t’u ankuar në zgjatjen e tepruar të procedurës”* pasi *“të ngrenë ankesë në gjykatat më të larta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme”*.

19. Më 1 korrik 2014, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë kërkesën e tyre të tretë, me të cilën e kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktvendimit (AC-I.-13-00415, të 5 qershorit 2014) të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

II. Procedura në gjykatat e rregullta

20. Më 4 dhjetor 2006, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi në DHPGJS, ku kërkuan rikthimin e pronës së paluajtshme, e cila ishte nacionalizuar për themelimin e Kooperativës bujqësore “Kosova” [më pas e njohur si “Ndërrmarrja Shoqërore Kosova Export”].
21. Më 31 janar 2007, Paneli i Specializuar i DHPGJS-së, me Aktvendimin SCC-06-0498, e referoi çështjen për gjykim në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
22. Më 16 prill 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi P. Nr. 236/97) gjykoi çështjen e referuar duke verifikuar pronësinë e parashtruesve mbi pronën e paluajtshme dhe urdhëroi që e njëjta t’i bartet në posedim parashtruesve të kërkesës.
23. Më 13 dhjetor 2007, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i Shtetit, Gjykata e Supreme (Aktvendimi Gzz. Nr. 36/2007) anuloi aktgjykimin e sipërpërmendur të Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Komunale.
24. Më 3 tetor 2011, pasi që çështja ishte kthyer te Gjykata Komunale në Prishtinë dhe përderisa rasti ishte ende në pritje të zgjidhej, parashtruesit parashtruan një padi paralele në DHPGJS dhe kërkuan që:
- a) Aktgjykimi (P. nr. 236/97, i 16 prillit 2007) i Gjykatës Komunale në Prishtinë të vërtetohet nga DHPGJS-ja, pasi që sipas parashtruesve të kërkesës *“ky aktgjykim nuk është ankimuar dhe si rrjedhojë është bërë i plotfuqishëm më 5 maj 2007”*; dhe
 - b) Aktvendimi (Gzz. Nr. 36/2007, i 13 dhjetorit 2007) i Gjykatës Supreme të Kosovës të shpallet i pavlefshëm, pasi që *“Gjykata Supreme nuk ka pasur kompetenca të shqyrtojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale P. nr. 236/97 sepse në përputhje me aktvendimin e referuar, SCC-06-0498, Dhoma e Posaçme e ka ruajtur juridiksionin ekskluziv ndaj çdo ankese kundër aktvendimit apo aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë”*.
25. Më 22 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë i dërgoi shkresat e lëndës [procedurë e përsëritur për rastin P. Nr. 236/97] për gjykim në DHPGJS. Rasti ishte regjistruar në DHPGJS me numrin C-III-12-1095 dhe ende është në pritje në DHPGJS.
26. Më 4 mars 2013, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në DHPGJS kërkesë për urdhër paraprak gjyqësor kundër tre të paditurve, përkatësisht Gjykatës Supreme të Kosovës [i padituri 1], M. M. [i padituri 2] dhe Ndërrmarrjes Shoqërore Kosova Eksport [i padituri 3].

27. Më 20 mars 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-ë me Aktvendimin SCC-11-0026 hodhi poshtë si të papranueshme padinë e parashtruesve dhe kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor. Në arsyetimin e aktvendimit të saj, DHPGJS-ja konstatoi:

“[...] Gjykata konstaton se padia SCC-06-0498, e cila fillimisht u parashtrua në Dhomën e Posaçme më 4 dhjetor 2006 dhe që është referuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë është ende në pritje të zgjidhet, për arsye se për atë nuk është vendosur me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës. Në pajtim me nenin 4.4 të LDHP-së rasti u kthye në Dhomën e Posaçme nga Gjykata Komunale në Prishtinë dhe aktualisht është në pritje të zgjidhet, dhe mban numrin C-III-12-1095. Dy nga paditësit [parashtruesit e kërkesës] e këtij rasti e kishin parashtruar padinë në fjalë ku kërkonin që Dhoma e Posaçme të konfirmojë aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë [Aktgjykimin P. nr. 236/97, të datës 16 prill 2007] i cili ishte anuluar nga Gjykata Supreme [Aktvendimi Gzz. Nr. 36/2007, i datës 13 dhjetor 2007], me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, pasi që rasti i parë është ende në pritje të zgjidhet dhe është parashtruar përpara rastit në fjalë, ky i fundit është dashur të hidhet poshtë në pajtim me nenin 262.3 dhe 262.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, nr. 03 /L-006 [...].

Prandaj, padia nuk i përmbush kërkesat e pranueshmërisë nga neni 28.2 i LDHP-së dhe refuzohet si e papranueshme. Rrjedhimisht, edhe kërkesa për urdhër paraprak gjyqësor është e papranueshme”.

28. Më 8 prill 2013, parashtruesit dorëzuan ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në Kolegjin e Ankesave të DHPGJS-së. Në ankesën e tyre, parashtruesit i kërkuan Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së “ta prishë aktvendimin e ankimuar, të konfirmojë se aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës është i pavlefshëm, ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. Nr 236/07, të 16 prillit 2007 dhe ta detyrojë Zyrën Kadastrale në Prishtinë ta zbatojë plotësisht këtë aktgjykim dhe t'i anulojë të gjitha transaksionet e kryera gjatë periudhës nga viti 2004 në lidhje me këtë çështje”.
29. Më 5 qershor 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së (Aktvendimi AC-I. 13-0041) refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar dhe konstatoi:

“Aktvendimi i ankimuar është i saktë dhe vërtetohet. Padia fillestare është ende në pritje të zgjidhet në DHPGJS [...]me numër C-III-13-1095. Objekti i çështjes është i njëjtë, sepse paditësi dëshiron të vazhdojë me padinë fillestare duke konfirmuar aktgjykimin fillestar të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe palët janë të njëjta, sepse shtimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në të njëjtën procedurë me të njëjtën kërkesë nuk bën asnjë ndryshim. Me fjalë të tjera, paditësit kërkojnë që e njëjta padi të gjykohet me të njëjtin aktgjykim [...]”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksi i Gjykatave], paragrafi 7.
31. Në mbështetje të pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *“Gjykata Supreme e Kosovës (edhe pse parashtruesit pretendonin mungesën e juridiksionit), si një gjykatë jokompetente, është pajtuar që të vendosë për kërkesën e PPK-së [Prokurorisë Publike të Kosovës], dhe mori një aktvendim të paligjshëm Gzz. Nr 36/2007 të datës 13.12.2007, i cili kishte krijuar një situatë të përhershme që ka zgjatur deri më sot”*.
32. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *“[...] Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme [...] nuk ka pasur përbërje të rregullt, pasi që ai do të duhej të përbëhej nga tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy (2) gjyqtarë vendorë, siç përcaktohet në nenin 3, paragrafi 12, të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Nr. 04/033, i cili është i zbatueshëm deri më 01.07.2014”*.
33. Në mbështetje të pretendimeve të tyre për tejzgjatje të procedurës, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Me aktvendimin e paligjshëm të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe më tutje me sjelljen e Gjykatës Themelore në Prishtinë, është krijuar një situatë e gjatë për gjithë periudhën 16.04.2007-13.12.2007-22.06.2012, e edhe më tutje, për shkak së cilës, parashtruesit nuk mund të disponojnë e të gëzojnë pronën sipas aktgjykimit të prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë P. no. 236/97 të datës 16.04.2007, i cili duhet ekzekutuar si aktgjykim i prerë [...]”*.
34. Në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre sipas nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“[...] me aktvendimin Gzz. Nr. 36/2007, të datës 13.12.2007, të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatë jokompetente në këtë procedurë, gjykata në mënyrë të paligjshme anuloi aktgjykimin e formës së prerë P. Nr. 236/97, të datës 16.04.2007, i cili na e pamundësoi gëzimin e të drejtës në pronë [...]”*.
35. Duke iu referuar pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 54, në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, të Kushtetutës, ata pretendojnë se *“[...] në vitin 2007, Prokurori Publik dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë ndërhyrë në kontest si institucione jokompetente [...]”*. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës *“[...] kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 25, paragrafi 1, në lidhje me nenin 182, paragrafi 2f, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Nr. 03/L-006, Nr. 04/L-118, që të zgjidhë konfliktin e kompetencave në këtë çështje juridike në mes të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe vetë Gjykatës Supreme të Kosovës”*.

36. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës me kërkesën si në vijim:

“Ne i propozojmë Gjykatës Kushtetuese që të prishë aktvendimin e Dhomës së Posaçme të GJSK AC-L-13-004/A001 të datës 05.06.2014 si dhe aktvendimin SCC-11-0226 të datës 20.03.2013, si dhe vendimin e gjykatës jokompetente – Gjykatës Supreme të Kosovës Cml-Gzz. nr. 36/2007 të datës 13.12.2007.

Të lihet në fuqi aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 236/97 të datës 16.04.2007 [...].”

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
38. Në mënyrë që të adresojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljet e pretenduara kushtetuese, Gjykata konsideron se ato mund të përmbliidhen dhe të ndahen si më poshtë:
- A) Pretendimet lidhur me vendimin e pretenduar të paligjshëm të Gjykatës Supreme [neni 31 i Kushtetutës];
 - B) Pretendimet lidhur me tejzgjatjen e procedurës [neni 31 në lidhje me nenin 46 të Kushtetutës];
 - C) Pretendimi se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk ka pasur përbërje të rregullt kur ka vendosur për ankesën e parashtruesve të kërkesës [neni 31 i Kushtetutës];
 - Ç) Pretendimi se Prokurori Publik dhe Gjykata e Supreme kanë ndërhyrë si institucione jokompetente në rastin e parashtruesve [neni 54 në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, i Kushtetutës].

A) Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve lidhur me vendimin e pretenduar të paligjshëm të Gjykatës Supreme [neni 31 i Kushtetutës]

39. Siç u theksua më lart, parashtruesit pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, duke pretenduar se Gjykata Supreme e Kosovës “[...] mori një aktvendim të paligjshëm Gzz. Nr 36/2007 të datës 13.12.2007, i cili kishte krijuar një situatë të përhershme që ka zgjatur deri më sot”.
40. Gjykata rikujton se ajo tashmë i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesve lidhur me “paligjshmërinë” e pretenduar të vendimit (Gzz. Nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007) të Gjykatës Supreme të Kosovës kur ka vendosur për kërkesën e parë të parashtruesve (KI18/10, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 gushtit 2011) duke konstatuar:

“36. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren që ajo ka të bëjë me çështje që kanë ndodhur para 15 qershorit 2008, dhe, si rrjedhojë, janë jashtë juridiksionit të Gjykatës. Prandaj, Gjykata duhet ta hedhë poshtë kërkesën si ratione temporis në mospërputhje.

37. Edhe po të supozohej se mund të ketë situatë të vazhdueshme në rastin në fjalë, nëse shkelja e Kushtetutës ishte shkaktuar nga një akt i kryer para hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe pasojat e atij akti origjinal ende ekzistojnë, që i japin kompetencë Gjykatës ta shqyrtojë ankesën, kërkesa është e papranueshme.

38. Në procedurën e 13 dhjetorit 2007, në të cilën parashtruesit nuk ishin të pranishëm, Gjykata Supreme e aprovoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 16 prillit 2006, dhe ia ktheu rastin Gjykatës Komunale për rigjykim. Deri më tani, parashtruesit nuk kanë dorëzuar asnjë dëshmi që tregon se Gjykata Komunale tashmë ka caktuar seancë dëgjimore dhe ka marrë vendim për këtë çështje, përveç që në Gjykatën Komunale i kanë parashtruar ankesat e njëjta si në këtë Gjykatë.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit, sipas të cilave individët që paraqesin kërkesë në Gjykatë duhet t'i shterin të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.”

41. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

[...]

d) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri [...].”

42. Gjykata dëshiron të theksojë se, edhe pse parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin AC-I.-13-0041 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, thelbi i pretendimeve të parashtruesve qëndron në pakënaqësinë e tyre me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Gzz. Nr. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007), me të cilin u anulua Aktgjykimi (P. Nr. 236/97, i 16 prillit 2007) i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe çështja u kthye në rigjykim.
43. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se pretendimet nën pikën A) janë të njëjta me pretendimet e bëra në kërkesën e parë të parashtruesve dhe të njëjtat janë trajtuar nga kjo Gjykatë në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI18/10.
44. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se, në bazë të rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës, nuk mund t'i rishqyrtojë pretendimet të cilat tashmë janë trajtuar nga Gjykata.

B) Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve lidhur me tejkzgatjen e procedurës [neni 31 në lidhje me nenin 46 të Kushtetutës]

45. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 46 të Kushtetutës sepse, sipas tyre, “është krijuar një situatë e gjatë për periudhën 16.04.2007-13.12.2007-22.06.2012, e edhe më tutje”, për shkak “të sjelljes së Gjykatës Themelore/Komunale në Prishtinë”.
46. Përveç kësaj, parashtruesit pretendojnë: “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i dha shkresave të rastit [...] numër të ri C-III-12-1095, por as ajo, që nga data 22.06.2012 e deri më sot nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi procedural, me gjasë prapë nga presioni i pronarëve të regjistruar në mënyrë të paligjshme të tokës në kontest”.
47. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata tërheq vëmendjen në nenin 47 (2) të Ligjit, i cili përcakton: “Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
48. Gjithashtu, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton: “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.
49. Për qëllim të vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve lidhur me tejkzgatjen e procedurës dhe me ndikimin që kjo tejkzgatje e pretenduar mund të ketë pasur në të drejtat e tjera kushtetuese të parashtruesve, Gjykata po ashtu rikujton arsyetimin e saj në rastin KI130/11, ku i ka refuzuar si të parakohshme pretendimet e parashtruesve në lidhje me “tejkzgatjen e procedurës”. Në atë rast, Gjykata ka theksuar:

“17. [...] për ankesën e parashtruesve të kërkesës, të cilën po e bëjnë tani para kësaj Gjykate lidhur me zgjatjen e tepruar të procedurës, nuk është vendosur ende nga Gjykata Komunale. Andaj, të gjitha argumentet lidhur me pretendimet e zgjatjes së tepruar të procedurës duhet paraqitur nga parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe nëse nuk janë të kënaqur, të ngrenë ankesë në gjykatat më të larta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme.

18. Nga kjo rrjedh se, në bazë të rregullit 36 (3) e) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme. Megjithatë, siç është cekur më parë, kjo nuk i parandalon parashtruesit e kërkesës nga parashtrimi i një kërkesë të re duke u ankuar për stërzgatje të procedurës”.

50. Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, lidhur me çështjen e tejkzgatjes së procedurës para autoriteteve vendore, ka përcaktuar disa kritere, të tilla si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e parashtruesve, sjellja e autoriteteve përkatëse, rreziku për parashtruesin në procedurë, gjendja (faza) e procedurës etj.

51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesit ankohen për sjelljen e autoriteteve përkatëse, konkretisht Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe DHPGJS-së.
52. Për sa i përket kritereve të sjelljes së autoriteteve përkatëse, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme e Kosovës ia ka kthyer lëndën për rigjykim Gjykatës Komunale, më 13 dhjetor 2007. Kjo e fundit vendosi ta bartë rastin për gjykim në DHPGJS, më 22 qershor 2012. Aktualisht, siç është konfirmuar nga Paneli i Specializuar i DHPGJS-ë dhe nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, rasti është në pritje të zgjidhet në DHPGJS.
53. Për më tepër, Gjykata po ashtu merr parasysh përgjigjen që ka pranuar nga DHPGJS lidhur me pretendimet e ngritura të parashtruesve për sa i përket stërzgjatjes së procedurës. Në shkresën e saj drejtuar Gjykatës, DHPGJS-ja theksoi:

“[...] Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme, më 17 Prill 2013, në bazë të kërkesës së paditësve ka marrë aktvendim për bashkimin e procedurës në këto dy lëndë dhe lëndën C-III-12-1100 ia ka bashkuar lëndës C-III-12-1095. Me të njëjtin aktvendim është urdhëruar zyra e regjistrimit të Dhomës së Posaçme që këtë lëndë ta regjistroj me numër të ri për Kolegjin e likuidimeve të Dhomës së Posaçme. [...] Kjo lëndë pasi që ka qenë mjaft voluminoze dhe e shpërndarë është kompletuar në zyrën e regjistrimit dhe me 19.09.2014 është dorëzuar në punë te gjyqtari. Tani e tutje lidhur me këtë lëndë do të vazhdoj procedura sipas rregullave të Ligjit për Dhomën e Posaçme, për çka palët do të njoftohen rregullisht”.

54. Në lidhje me periudhën kohore 2007-2012, Gjykata rikujton se Gjykata Komunale ka paraqitur një shpjegim i cili është dorëzuar më 22 shkurt 2012, gjatë kohës që Gjykata ishte duke vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës së dytë të parashtruesve, KI130/11. Në shpjegimin e saj, Gjykata Komunale kishte deklaruar:

“[...] Gjykata aktualisht është duke e vlerësuar kompetencën lëndore të saj, duke pasur parasysh që në të gjitha paditë e përmendura e paditur është Kooperativa Bujqësore Kosova [...] dhe sepse ndërkohë ka hyrë në fuqi Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Ju informoj se rasti është caktuar për në dhjetor 2010 dhe për shkak të kompleksitetit të tij dhe numrit shumë të madh të rasteve në të cilat jemi duke punuar aktualisht, nuk kemi pasur mundësi ta caktojmë seancën para vitit 2011, si dhe po ashtu për arsye se adresat e paditësve janë në Republikën e Serbisë, që e bën komunikimin edhe më të vështirë”.

55. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nga DHPGJS-ja nuk është marrë asnjë vendim gjyqësor i formës së prerë, pas Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë për ta bartur gjykimin e rastit të DHPGJS-ja. Në fakt, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së (Aktvendimi AC-I.-13-0041, i 5 qershorit 2014) e refuzoi ankesën e parashtruesve kundër Aktvendimit (SCC-11-0226, të 23 marsit 2013) të DHPGJS-së, pikërisht për arsyen se “*padia është ende në pritje të zgjidhet*”. Më konkretisht, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konstatoi:

“[...] Padia fillestare, me numër C-III-13-1095, është ende në pritje të zgjidhet në DHPGJS. Objekti i çështjes është i njëjtë, sepse paditësi dëshiron të vazhdojë me padinë fillestare duke konfirmuar aktgjykimin fillestar të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe palët janë të njëjta [...]. Me fjalë të tjera, paditësit kërkojnë që e njëjta padi të gjykohet me të njëjtin aktgjykim”.

56. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se kërkesa duhet të vlerësohet si e parakohshme, sepse rasti i parashtruesve është ende në procedurë të rregullt gjyqësore dhe se shkeljet e pretenduara kushtetuese sipas pikës B) ende mbeten për t'u vlerësuar nga gjykatat e rregullta.
57. Në këto rrethana dhe, në veçanti, në lidhje me pretendimet e parashtruesve në pikën B), Gjykata vëren se parashtruesit nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe për këtë arsye Gjykata e refuzon këtë pjesë të kërkesës si të parakohshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

C) Për sa i përket pretendimit të parashtruesve se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk ka pasur përbërje të rregullt kur ka vendosur për ankesën e parashtruesve të kërkesës [neni 31 i Kushtetutës]

58. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

59. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës vetëm kanë theksuar që *“Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përbëhej nga tre gjykatës kombëtarë dhe dy ndërkombëtarë”*, duke mos mbështetur pretendimin se si mund të ketë shkelur kjo të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
60. Duke marrë parasysh thëniet e mësipërme, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në pikën C) duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara, duke marrë parasysh se parashtruesit nuk kanë mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tyre për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës.

Ç) Për sa i përket pretendimit se Prokurori Publik dhe Gjykata e Supreme kanë ndërhyrë si institucione jokompetente në rastin e parashtruesve [neni 54, në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, i Kushtetutës]

61. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është shkelur neni 54, në lidhje me nenet 102 dhe 103, paragrafi 7, i Kushtetutës sepse, sipas tyre, *“në vitin 2007, Prokurori Publik dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë ndërhyrë në kontest si institucione jo kompetente”.*

62. Parashtruesit e kërkesës përpiqen ta argumentojnë pretendimin për shkelje duke pohuar: *“Procedura kontestimore është udhëhequr nga parashtruesit e kërkesës para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me AKM-në, si gjykata e vetme kompetente dhe më e lartë në Kosovë për këto çështje [...]”*.
63. Për ta korrigjuar këtë pretendim për shkelje kushtetuese, parashtruesit kërkojnë që Gjykata *“ta zgjidhë konfliktin e kompetencave në këtë çështje juridike midis Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe vetë Gjykatës Supreme të Kosovës”*.
64. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, i cila parasheh: *“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: e) kërkesa nuk është racione materiae në pajtim me Kushtetutën.”*
65. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se çështja e zgjidhjes së *“konfliktit të kompetencave”* ndërmjet DHPGJS-së dhe Gjykatës Supreme, apo të çfarëdo konflikti tjetër të kompetencave ndërmjet gjykatave të rregullta, nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.
66. Rrjedhimisht, Gjykata i refuzon pretendimet e bëra në pikën D), në pajtim me rregullin 36 (3) e), sepse kërkesa e parashtruesve nuk është *racione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
67. Si përfundim, Gjykata konstaton se kjo kërkesë duhet të deklarohet e papranueshme për shkaqet e mëposhtme:
- i) Lidhur me pretendimet në pikën A), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3) d);
 - ii) Lidhur me pretendimin në pikën B), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës;
 - iii) Lidhur me pretendimin në pikën C), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) d) të Rregullores së punës; dhe
 - iv) Lidhur me pretendimin në pikën Ç), kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

68. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata të caktojë Masë të përkohshme, përkatësisht të ndalojë shitjen, rishitjen, dhënien me qira dhe nënqira, ndërtimin ose vënien e çfarëdo ngarkese mbi ngastrën kadastrale që është objekt kryesor i këtij kontesti.

69. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë:

“Për shkak të mosekzistimit të masës së përkohshme për ndalimin e ndryshimit të pronësisë mbi ngastrën kadastrale nr. 1536/1 [...] bazuar në Aktgjykimin e rremë/të pavlefshëm P. nr. 395/96, e ka bartur të drejtën e pronësisë tek M. M. nga fshati Uglare – Komuna e Gracanicës në bazë të kontratave të pavlefshme për shitblerje, të lidhura më 19.03.2004, me M. M. dhe disa persona fizikë nga Prishtina, më 14.05.2012, e ka bartur të drejtën e pronësisë tek blerësit e rinj “joliqjorë”. Ne [...] e lusim Gjykatën e titullit të parandalojë veprimet e planifikuara të rishitjes, dhe që urgjent sipas kërkesës-ankesës sonë kushtetuese të datës 01.07.2014, dhe sipas propozimit, të caktojë këtë:

MASË TË PËRKOHSHME

Ndalohet: shitja, rishitja, dhënia me qira dhe nënqira, ndërtimi dhe vënia e çfarëdo ngarkese mbi ngastrën kadastrale [...] ka qenë e evidentuar në fletën poseduese nr. 4011 ZK Prishtinë në emrin e shfrytëzuesit KBI “K.E” Ndërmarrje Shoqërore, kurse prej datës 14.05.2012 evidentohet në emrin e disa pronarëve privatë joliqjorë, deri në përfundimin e plotfuqishëm të kësaj procedure.

Këtë masë do ta zbatojnë: Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës dhe inspektorati kompetent ndërtimor i Komunës së Prishtinës”.

70. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se procedura është ende duke u zhvilluar në gjykatat e rregullta. Prandaj, Gjykata konsideron që kërkesa për Masë të përkohshme nuk është e zbatueshme, për arsye se nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me Ligj dhe me Rregullore të punës.
71. Në mënyrë që Gjykata të lejojë Masë të përkohshme, në përputhje me rregullat 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, ajo duhet të konstatojë:

[...]

(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për

pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme.

(c) Masa e përkohshme është me interes publik.

[...]

5) Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

72. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme dhe, prandaj, nuk ekziston rasti *prima facie* për caktimin e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36 (1) b), 36 (2) (d), 36 (3) (d), 36 (3) (e), 55 (4) dhe (5), dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani